

Bazuar në nenin 33 paragrafin 5 të Ligjit për Arsimin e Mesëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/2016, 127/16, 67/17 dhe 64/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" Nr. 229/20, 78/25 dhe 132/25) ministrja e Arsimit dhe Shkencës solli

Rregullore
për mënyrën e sigurimit e mjeteve financiare
për maturën ndërkombëtare në arsimin e mesëm

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e sigurimit të mjeteve për maturën ndërkombëtare në arsimin e mesëm.

Neni 2

Mjetet financiare për realizimin e maturës ndërkombëtare në shkollën e mesme ku realizohet matura ndërkombëtare miratohen nga llogaria e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (në tekstin e mëtejshëm: Ministria), pas kërkesës së dorëzuar më parë nga shkolla e mesme dhe dokumentacionit përkatës.

Neni 3

Mjetet nga neni 2 i kësaj rregulloreje miratohen për këto qëllime:

- anëtarësimi vjetor (sipas dokumentit nga International Baccalaureate, Geneve, Switceland),
- shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit në hotel në lidhje me trajnimet dhe bashkëpunimin ndërkombëtar,
- kontrollimi i kandidatëve (nëse nxënësit arrijnë rezultate të pakënaqshme në test dhe duhet ta përsërisin atë, ata janë të detyruar të mbulojnë vetë shpenzimet e kontrollimit të përsritur),
- tekste shkollore, literaturë tjetër profesionale dhe publikime për bibliotekën e shkollës së mesme,
- materiale të zyrës,
- mjete ndihmëse mësimore dhe edukative,
- pajisje edukative-mësimore për procesin arsimor,
- shpenzime për punë laboratorike dhe softuerë edukativë,
- përdorimi i shërbimeve të korrierit të shërbimit DHL dhe
- komisioni bankar dhe diferenca e kursit të këmbimit gjatë blerjes së valutës së huaj dhe të tjera.

Neni 4

Byroja për Zhvillimin e Arsimit (në tekstin e mëtejshëm: Byroja) siguron mjete financiare për:

- trajnime për mësime ndërkombëtare që i nënshtrohen provimit ndërkombëtar të maturës në arsimin e mesëm dhe
- bashkëpunimi ndërkombëtar i shkollës së mesme në të cilën realizohet matura ndërkombëtare për CAS (creativity, action, service).

Neni 5

Ministria, përkatësisht Byroja, mjetet financiare të neneve 2, 3 dhe 4 të kësaj rregulloreje i transferon në llogarinë e shkollës së mesme ku zhvillohet matura ndërkombëtare.

Neni 6

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje pushonë së vlefshmi Udhëzimi për mënyrën e sigurimit të mjeteve financiare për realizimin e maturës ndërkombëtare në arsimin e mesëm me numër 11-2023/1 të datës 23.04.2013 dhe me numër 07-11346/1 të datës 07.08.2014.

Neni 7

Kjo rregullore hyn në fuqi të nesërmen nga dita e sjelljes së saj.

**Министерка за образование и наука,
Ministre e Arsimit dhe Shkencës
проф. д-р Весна Јаневска, с.р.**

Nr. 13-12562/1

26.09.2025

Shkup